Raport krahasimor për vlerësimin institucional me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset

Shkolla Profesionale “Hamdi Bushati” Shkodër

Viti shkollor 2025 - 2026

Shtator 2026

Tabela e përmbajtjes

Lista e Tabelave 3

Hyrje 5

Metodologjia 5

Të dhëna për pjesëmarrësit 2026 8

Rezultatet 9

- Zhvillimi i vazhduar profesional 9
- Kurrikula 10
- Marrëdhënia me biznesit 11
- Orientimi në karrierë 12
- Projektet 13
- Marketingu 14
- Gjurmimi në nivel ofruesi 15

Shtojca 1 – Tabela exel me të dhënat nga sondazhi 16

Lista e Tabelave

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup 8
Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional 9
Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës 10
Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin 11
Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë 12
Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve 13
Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut 14
Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi 15

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" (S4J)

Aftësi për Punë (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Swisscontact, i cili synon të adresojë sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri. Që prej tetorit 2015, projekti "Aftësi për Punë" (S4J) mbështet qeverinë dhe aktorët e tjerë të interesit për të ndërtuar një sistem cilësor të AFP në Shqipëri, i frymëzuar nga modeli zviceran. Në fazën e tij të tretë (2024-2027), me theks të veçantë tek qëndrueshmëria, projekti është angazhuar në ndarjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe përvojave të përftuara në nivel sistemi, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat partnere.

Hyrje

Ky raport paraqet gjetjet nga procesi i **Vlerësimit Institucional** të zhvilluar në Shkollën **"Hamdi Bushati"** për vitin shkollor 2025 - 2026. Procesi, me synim vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të aftësimit profesional, përfshiu nxënës, mësues, prindër dhe biznese partnere, të cilët u anketuan gjatë periudhës maj-qershor 2026. Ky vit shënon realizimin e procesit për të dytin vit radhazi, duke e konsoliduar si një praktikë të qëndrueshme dhe të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Procesi u koordinua nga Njësia e Zhvillimit (NjZH) në shkollë, e cila luan një rol kyç në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve. Përshkrimi i gjetjeve në raport është i organizuar sipas treguesve për secilin funksion të NJZH-së.

Ky proces vlerësues mbështetet në përvojën e vitit shkollor 2024 - 2025, ku projekti 'Aftësi për Punë' (S4J), në bashkëpunim me gjashtë shkolla partnere[1], zhvilloi katër instrumente vlerësimi (pyetësorë), të bazuar në një metodologji rigoroze dhe pjesëmarrëse. Pas pilotimit në gjashtë shkolla, instrumentet u rishikuan për të garantuar vlefshmëri, qëndrueshmëri dhe respektim të standardeve etike[2].

Metodologjia

Në kuadër të mbledhjes së informacionit që do të ushqejë analizën vjetore të performancës institucionale, në përfundim të çdo viti shkollor do të realizohet një proces vlerësimi institucional në nivel ofruesi duke përfshirë katër grupeve kryesore: nxënës, mësues, biznese dhe prindër. Ky proces synon të vlerësojë performancën institucionale, të identifikojë fushat për përmirësim dhe të informojë objektivat e planit vjetor të institucionit.

Për këtë qëllim, janë zhvilluar katër instrumente vlerësimi (pyetësor), si vijon:

Pyetësori për nxënësit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e nxënësve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në cilësinë e mësimdhënies, praktikën profesionale, orientimin në karrierë dhe performancën e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i programeve për të përgatitur më mirë nxënësit për tregun e punës.

Pyetësori për mësuesit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e mësuesve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional dhe mjedisit të të nxënit. Fokusohet në zhvillimin profesional, zbërthimin e kurrikulës, projektet zhvillimore dhe dhe performancën e institucionit. Qëllimi është identifikimi i fushave për përmirësim dhe përshtatja e praktikave me nevojat e stafit dhe nxënësve.

Pyetësori për bizneset synon të mbledh perceptimet e bizneseve për cilësinë e bashkëpunimit me institucionin dhe përvojën me nxënësit gjatë praktikës profesionale. Fokusohet

[1] Hamdi Bushati, Kolin Gjoka, Kristo Isak, Shkolla Profesionale Elbasan, Shkolla Teknike Ekonomike Tirane, Tregtare.
[2] Për më shumë informacion, shih raportin Baseline i treguesve të cilësisë së Njësisë së Zhvillimit https://skillsforjobs.al/publications/baseline-i-treguesve-te-cilesise-se-njesise-se-zhvillimit/

në përgatitjen e nxënësve, përputhshmërinë e programeve të praktikës me nevojat e tregut të punës dhe mundësitë për përmirësim. Qëllimi është forcimi i bashkëpunimit dhe angazhimi cilësor i sektorit privat në proceset e aftësimit profesional.

Pyetësori për prindërit synon të mbledhë mendimet e prindërve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në komunikimin me shkollën, orientimin në karrierë të fëmijëve dhe imazhin e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i shërbimeve për të përmbushur pritshmëritë dhe nevojat e nxënësve dhe prindërve.

SHKOLLA PROFESIONALE
HAMDI BUSHATI

Aftësi për Punë
Skills for Jobs

Të dhëna për pjesëmarrësit 2026

Për vitin shkollor 2025-2026, në sondazh morën pjesë gjithsej 125 nxënës të shkollës profesionale “Hamdi Bushati”. Përbërja gjinore e grupit të të anketuarve tregon një pjesëmarrje më të lartë të djemve, të cilët përbëjnë 68,0% (N=85) të kampionit, ndërsa vajzat përbëjnë 32,0% (N=40). Sa i përket shpërndarjes sipas klasave, nga 124 nxënës me përgjigje të vlefshme, 88,7% (N=110) e nxënësve ishin në klasën e trembëdhjetë, 4,8% (N=6) në arsimin profesional pas të mesëm, 3,2% (N=4) në klasën e njëmbëdhjetë, ndërsa 1,6% (N=2) në klasën e dhjetë dhe 1,6% (N=2) në klasën e dymbëdhjetë.

Në anketim morën pjesë gjithsej 15 mësues të shkollës profesionale “Hamdi Bushati”. Përbërja gjinore e të anketuarve tregon se 80,0% (N=12) ishin gra, ndërsa 20,0% (N=3) ishin burra. Sa i përket grupit të lëndëve në të cilat japin mësim mësuesit e anketuar, nga 15 mësues, 60,0% (N=9) japin mësim si në lëndët e teorisë profesionale, ashtu edhe në modulet e praktikës profesionale. Ndërkohë, 33,3% (N=5) japin mësim në lëndët e teorisë profesionale, ndërsa 6,7% (N=1) japin mësim vetëm në modulet e praktikës profesionale.

Për bizneset partnere të shkollës profesionale “Hamdi Bushati”, të dhënat tregojnë se nga 12 biznese të anketuara, 58,3% (N=7) deklarojnë se kanë një bashkëpunim të ngushtë me shkollën, ndërsa 41,7% (N=5) e vlerësojnë bashkëpunimin si të mirë. Sa i përket formave të bashkëpunimit, 100,0% (N=12) e bizneseve të anketuara deklarojnë se bashkëpunojnë me shkollën përmes mbi 5 modaliteteve të bashkëpunimit. Kjo tregon se të gjitha bizneset pjesëmarrëse në sondazh janë të përfshira në forma të shumëllojshme bashkëpunimi me shkollën.

Për prindërit e nxënësve të shkollës profesionale “Hamdi Bushati”, në sondazh morën pjesë gjithsej 2 prindër. Përbërja gjinore është e barabartë, ku 50,0% (N=1) janë gra dhe 50,0% (N=1) janë burra. Sa i përket klasës ku ndjek shkollën fëmija, 100,0% (N=2) e prindërve të anketuar kanë deklaruar se fëmija i tyre ndjek klasën e njëmbëdhjetë. Për shkak të numrit shumë të ulët të prindërve të përfshirë në sondazhin e vitit 2026 (N=2), rezultatet për treguesit që përfshijnë prindërit nuk konsiderohen përfaqësuese dhe, për rrjedhojë, nuk mund të krahasohen në mënyrë të besueshme me rezultatet e viteve të mëparshme.

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup

Përfituesit	**2024**	**2025**	**2026**
Nxënës	164	309	125
Mësues	21	38	15
Prindër	138	98	2
Biznese	109	56	12

Rezultatet

Seksionet më poshtë përmbledhin rezultatet e matjeve me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset. Ndërkohë, listën e plotë të gjetjeve për cdo pyetësor e gjeni në Shtojcën 1.

Zhvillimi i vazhduar profesional

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 9,1% në përputhjen e aktiviteteve të ZHVP-së me nevojat e mësuesve, nga 84,2% në 2025 në 93,3% në 2026. Në të kundërt, vlerësimi se aftësitë e mësuesve janë përmirësuar nga trajnimet dhe aktivitetet e parashikuara në planin e ZHVP-së është ulur me 5,4%, nga 92,1% në 2025 në 86,7% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (100,0%), treguesi është ulur me 13,3%. Edhe kënaqësia e mësuesve me mbështetjen e marrë gjatë zbatimit të planit të ZHVP-së është ulur me 9,2%, nga 89,2% në 2025 në 80,0% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (90,5%), treguesi është ulur me 10,5%. Ndërkohë, aplikimi në mësimdhënie i njohurive, aftësive, shprehive dhe metodave të reja të mësimdhënies të përfituara nga trajnimet dhe shkëmbimet është rritur ndjeshëm me 20,3%, nga 71,4% në 2025 në 91,7% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (95,0%), treguesi është ulur me 3,3%.

Te nxënësit, krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një ulje prej 9,3% në kënaqësinë me metodat e mësimdhënies, nga 72,5% në 2025 në 63,2% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (72,0%), treguesi është ulur me 8,8%. Në të kundërt, kënaqësia me metodat e përdorura gjatë procesit të mësimdhënies është rritur me 21,7%, nga 54,4% në 2025 në 76,1% në 2026. Gjithashtu, kënaqësia e nxënësve me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor është rritur me 5,9%, nga 64,4% në 2025 në 70,3% në 2026, ndërsa krahasuar me vitin 2024 (62,2%), është rritur me 8,1%.

Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit e kulturës profesionale – përfitues direkt	1. Aktivitetet e ZHVP janë në përputhje me nevojat e mësuesve.	90.5	84.2	93.3
	2. Aftësitë e mësuesve janë përmirësuar nga trajnimet/aktivitetet e parashikuara në planin e ZHVP.	100.0	92.1	86.7
	3. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë gjatë zbatimit të planit të ZHVP.	90.5	89.2	80.0
	4. Mësuesit aplikojnë në mësimdhënie njohuritë aftësitë, shprehitë dhe metodat e reja të mësimdhënies që kanë mësuar në trajnime dhe shkëmbime.	95.0	71.4	91.7
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e mësimdhënies (si p.sh., puna në grup, puna	72.0	72.5	63.2

	me projekte, përdorimi i teknologjisë, ndërveprimi në klasë etj.).			
	2. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e përdorura gjatë procesit të mësimdhënies.		54.4	76.1
	3. Nxënësit janë të kënaqur me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor.	62.2	64.4	70.3

Kurrikula

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 7,8% në lehtësinë e mësuesve për zbërthimin e kurrikulës në përputhje me nevojat rajonale të tregut të punës, nga 72,2% në 2025 në 80,0% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (66,7%), treguesi është rritur me 13,3%. Në të kundërt, kënaqësia e mësuesve me mbështetjen e marrë nga koordinatori i kurrikulës për zbatimin e mësimdhënies është ulur me 18,8%, nga 92,1% në 2025 në 73,3% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (90,5%), treguesi është ulur me 17,2%.

Te nxënësit, vlerësimi se programi mësimor është i përshtatur me tregun e punës është rritur me 3,2%, nga 82,2% në 2025 në 85,4% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (82,6%), treguesi është rritur me 2,8%.

Te bizneset, kënaqësia me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që kanë marrë nxënësit në shkollë është ulur me 8,6%, nga 83,6% në 2025 në 75,0% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (66,7%), treguesi mbetet 8,3% më i lartë. Ndërkohë, vlerësimi i bizneseve se planet e praktikës profesionale janë në përshtatje me nevojat e tyre ka mbetur i pandryshuar në 66,7% në vitet 2025 dhe 2026. Krahasuar me vitin 2024 (61,5%), treguesi është rritur me 5,2%.

Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit e kanë më të lehtë zbërthimin e kurrikulës në përputhet me nevojat rajonale të tregut të punës.	66.7	72.2	80.0
	2. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë nga koordinatori i kurrikulës për zbatimin e mësimdhënies	90.5	92.1	73.3
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit mendojnë se programi mësimor është e përshtatur me tregun e punës.	82.6	82.2	85.4
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset janë të kënaqur me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që kanë marrë nxënësit në shkollë.	66.7	83.6	75.0
	2. Bizneset mendojnë se planet e praktikës profesionale janë në përshtatje me nevojat e tyre.	61.5	66.7	66.7

Marrëdhënia me biznesit

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 20,7% në përqindjen e nxënësve që kanë bërë praktikë profesionale në biznes, nga 75,1% në 2025 në 95,8% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (73,2%), treguesi është rritur me 22,6%. Në të kundërt, niveli i kënaqësisë së nxënësve me mundësitë që ofron shkolla për praktikë profesionale në biznes është ulur me 17,1%, nga 80,4% në 2025 në 63,3% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (84,7%), treguesi është ulur me 21,4%. Gjithashtu, niveli i kënaqësisë së nxënësve me realizimin e praktikës profesionale në biznes sipas planit të praktikës është ulur me 10,9%, nga 77,8% në 2025 në 66,9% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (82,8%), treguesi është ulur me 15,9%.

Te bizneset, bashkëpunimi në forma të ndryshme me shkollën është rritur me 7,9%, nga 92,1% në 2025 në 100,0% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (69,7%), treguesi është rritur me 30,3%. Kënaqësia e bizneseve për bashkëpunimin me shkollën është rritur me 7,3%, nga 74,5% në 2025 në 81,8% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (72,4%), treguesi është rritur me 9,4%. Bizneset që deklarojnë se bashkëpunojnë ngushtë me shkollën janë rritur me 23,1%, nga 35,2% në 2025 në 58,3% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (22,9%), treguesi është rritur me 35,4%. Ndërkohë, kënaqësia e bizneseve me cilësinë e përgatitjes së nxënësve nga shkolla është ulur me 8,6%, nga 83,6% në 2025 në 75,0% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (84,4%), treguesi është ulur me 9,4%. Vlerësimi i bizneseve se shkolla përmbush nevojat e tyre për aftësi cilësore pune është rritur me 0,3%, nga 83,0% në 2025 në 83,3% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (68,8%), treguesi është rritur me 14,5%. Njohja e programit mësimor nga bizneset është ulur me 0,3%, nga 83,6% në 2025 në 83,3% në 2026, ndërsa krahasuar me vitin 2024 (62,0%), treguesi është rritur me 21,3%. Së fundi, njohja shumë e mirë e moduleve profesionale nga bizneset është rritur me 1,8%, nga 81,5% në 2025 në 83,3% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (68,8%), treguesi është rritur me 14,5%.

Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Nxënësit – përfitues direkt	1. % e nxënësve që kanë bërë praktikë profesionale në biznes.	73.2	75.1	95.8
	2. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me mundësitë që ofron shkolla për praktikë profesionale në biznes.	84.7	80.4	63.3
	3. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me realizimin e praktikës profesionale në biznes sipas planit të praktikës.	82.8	77.8	66.9
Bizneset – përfitues direkt	1. Bizneset bashkëpunojnë në forma të ndryshme me shkollën.	69.7	92.1	100.0
	2. Bizneset janë të kënaqura për bashkëpunimin me shkollën.	72.4	74.5	81.8
	3. Bizneset bashkëpunojnë ngushtë me shkollën.	22.9	35.2	58.3
	4. Bizneset janë të kënaqur me cilësinë e përgatitjes së nxënësve nga shkolla.	84.4	83.6	75.0

	5. Bizneset mendojnë se shkolla përmbush nevojat e biznesit për aftësi cilësore pune.	68.8	83.0	83.3
	6. Biznesi njeh programin mësimor që ofron shkolla.	62.0	83.6	83.3
	7. Biznesi njeh shumë mirë modulet profesionale qe ofron shkolla.	68.8	81.5	83.3

Orientimi në karrierë

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një ulje prej 1,6% në përqindjen e nxënësve që kanë marrë shërbime të ndryshme për orientimin në karrierë, nga 90,7% në 2025 në 89,1% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (86,0%), treguesi është rritur me 3,1%. Kënaqësia e nxënësve me cilësinë e shërbimit të ofruar në sesionet e orientimit në karrierë është ulur me 0,2%, nga 80,2% në 2025 në 80,0% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (75,5%), treguesi është rritur me 4,5%. Ndërkohë, informimi i nxënësve për shanset e punësimit pas diplomimit në profilin që po studiojnë është rritur ndjeshëm me 25,1%, nga 53,9% në 2025 në 79,0% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (62,2%), treguesi është rritur me 16,8%.

Në vitin 2026, 50,0% e prindërve të anketuar shprehen të kënaqur me shërbimin e orientimit në karrierë që shkolla i ofron fëmijës së tyre. Për shkak të numrit shumë të ulët të prindërve të përfshirë në sondazh (N=2), ky rezultat nuk konsiderohet përfaqësues dhe nuk mund të krahasohet në mënyrë të besueshme me rezultatet e viteve të mëparshme.

Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit kanë marrë shërbime të ndryshme për orientimin në karrierë.	86.0	90.7	89.1
	2. Nxënësit janë të kënaqur me cilësinë e shërbimit të ofruar në sesionet e orientimit në karrierë.	75.5	80.2	80.0
	3. Nxënësit janë të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit në profilin që po studiojnë.	62.2	53.9	79.0
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit janë të kënaqur me shërbimin për orientim në karrierë që i jep shkolla fëmijës.	71.0	69.8	50.0
	2. Prindërit besojnë se orientimi në karrierë e ka ndihmuar fëmijën për të marrë vendimet e duhura për karrierën.	73.9	74.2	0.0*

***Shenim:** Numri i kampionit te prinderve eshte shume i ulet dhe nuk ka kategori per kete indikator.

Projektet

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 2,5% në njohjen e projekteve zhvillimore të shkollës nga mësuesit, nga 84,2% në 2025 në 86,7% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (61,9%), treguesi është rritur me 24,8%. Në të kundërt, vlerësimi i mësuesve se projektet zhvillimore të shkollës përmirësojnë cilësinë e arsimit është ulur me 3,0%, nga 76,3% në 2025 në 73,3% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (76,2%), treguesi është ulur me 2,9%. Përfshirja e mësuesve në shkrimin e projekteve zhvillimore si pjesë e grupeve të punës është ulur me 10,1%, nga 36,8% në 2025 në 26,7% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (33,3%), treguesi është ulur me 6,6%. Edhe përfshirja e mësuesve në zbatimin e projekteve zhvillimore është ulur me 4,9%, nga 31,6% në 2025 në 26,7% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (42,9%), treguesi është ulur me 16,2%.

Te nxënësit, njohja e projekteve zhvillimore në shkollë është rritur me 9,0%, nga 61,2% në 2025 në 70,2% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (43,8%), treguesi është rritur me 26,4%. Ndërkohë, përfshirja e nxënësve në projekte zhvillimore është ulur me 9,8%, nga 66,1% në 2025 në 56,3% në 2026. Megjithatë, krahasuar me vitin 2024 (14,6%), treguesi është rritur me 41,7%. Kënaqësia e nxënësve me përfshirjen në aktivitetet e projekteve të zhvilluara nga shkolla është rritur me 4,8%, nga 70,2% në 2025 në 75,0% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (77,6%), treguesi është ulur me 2,6%. Në të kundërt, kënaqësia e nxënësve me rezultatet e projekteve të zbatuara nga shkolla është ulur me 8,7%, nga 72,3% në 2025 në 63,6% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (70,4%), treguesi është ulur me 6,8%.

Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit i njohin projektet zhvillimore të shkollës	61.9	84.2	86.7
	2. Mësuesit mendojnë se projektet zhvillimore të shkollës përmirësojnë cilësinë e arsimit	76.2	76.3	73.3
	3. Mësuesit janë të përfshirë në shkrimin e projekteve zhvillimore si pjesë e grupeve të punës	33.3	36.8	26.7*
	4. Mësuesit janë të përfshirë zbatimin e projekteve zhvillimore.	42.9	31.6	
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit janë të dijeni të projekteve zhvillimore në shkollë.	43.8	61.2	70.2
	2. Nxënësit janë të përfshirë në projekte zhvillimore	14.6%	66.1	56.3
	3. Nxënësit janë të kënaqur me përfshirjen në aktivitete të projekteve të zhvilluara nga shkolla.	77.6%	70.2	75.0
	4. Nxënësit janë të kënaqur me rezultatet e projekteve të zbatuara nga shkolla.	70.4%	72.3	63.6

Shënim: *Treguesit 3 dhe 4 janë llogaritur vetëm për mësuesit që raportuan pjesëmarrje në grupet e punës për projektet zhvillimore (N=4; 26.7% e kampionit total të shkollës).

Marketingu

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 6,8% në kënaqësinë e mësuesve me aktivitetet e planit të marketingut të shkollës, nga 78,9% në 2025 në 85,7% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (95,2%), treguesi është ulur me 9,5%. Vlerësimi i mësuesve për cilësinë e materialeve informuese të marketingut është ulur me 20,3%, nga 91,7% në 2025 në 71,4% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (100,0%), treguesi është ulur me 28,6%. Ndërkohë, kënaqësia e mësuesve me imazhin e shkollës është rritur me 1,5%, nga 84,2% në 2025 në 85,7% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (90,5%), treguesi është ulur me 4,8%. Përfshirja e mësuesve në aktivitetet e marketingut të shkollës është rritur me 15,1%, nga 31,6% në 2025 në 46,7% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (14,3%), treguesi është rritur me 32,4%.

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një ulje prej 31,1% në kënaqësinë e nxënësve me aktivitetet e marketingut të shkollës, nga 65,8% në 2025 në 34,7% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (62,5%), treguesi është ulur me 27,8%. Vlerësimi i nxënësve për cilësinë e informacionit të dhënë në materialet e marketingut është ulur me 23,0%, nga 79,0% në 2025 në 56,0% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (72,6%), treguesi është ulur me 16,6%. Kënaqësia e nxënësve me imazhin e shkollës është ulur me 5,5%, nga 71,9% në 2025 në 66,4% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (62,5%), treguesi është rritur me 3,9%. Ndërkohë, përfshirja e nxënësve në aktivitetet e marketingut është rritur me 7,2%, nga 27,5% në 2025 në 34,7% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (17,5%), treguesi është rritur me 17,2%.

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një ulje prej 7,6% në vlerësimin e bizneseve për reputacionin dhe imazhin e mirë të shkollës, nga 90,9% në 2025 në 83,3% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (89,9%), treguesi është ulur me 6,6%.

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 46,9% në vlerësimin e prindërve për imazhin e mirë të shkollës, nga 53,1% në 2025 në 100,0% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (64,2%), treguesi është rritur me 35,8%.

Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues indirekt	1. Mësuesit janë të kënaqur me aktivitetet e planit të marketingut të shkollës.	95.2	78.9	85.7
	2. Mësuesit mendojnë se materialet informuese për marketingun janë cilësore	100.0	91.7	71.4
	3. Mësuesit janë të kënaqur me imazhi që ka shkollë	90.5	84.2	85.7

	4. Mësuesit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut të shkollës.	14.3	31.6	46.7
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me aktivitetet e marketingut të shkollës	62.5	65.8	34.7
	2. Nxënësit mendojnë se informacioni i dhënë në materialet e marketingut është cilësor.	72.6	79.0	56.0
	3. Nxënësit janë të kënaqur me imazhit të shkollës.	62.5	71.9	66.4
	4. Nxënësit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut.	17.5	27.5	34.7
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset e vlerësojnë shkollën si institucion me reputacion/ imazh të mirë.	89.9	90.9	83.3
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit e nxënësve të shkollës dhe nxënësve të klasave të 8-9 vlerësojnë shkollën si institucion me imazh të mirë.	64.2	53.1	100.0

Gjurmimi në nivel ofruesi

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një ulje prej 31,2% në përdorimin e të dhënave të gjurmimit nga drejtuesit dhe mësuesit për përmirësimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve të lidhura me të, nga 57,9% në 2025 në 26,7% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (57,1%), treguesi është ulur me 30,4%. Ndërkohë, përdorimi i të dhënave të gjurmimit nga shkolla për përmirësimin e aktivitetit vjetor është rritur me 17,0%, nga 76,3% në 2025 në 93,3% në 2026. Krahasuar me vitin 2024 (81,0%), treguesi është rritur me 12,3%.

Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Drejtuesi dhe Mësuesit – përfitues direkt	1. Drejtuesit dhe mësuesit përdorin të dhënat e gjurmimit për të përmirësuar procesin mësimor dhe aktivitetet e lidhura me të.	57.1	57.9	26.7
	2. Shkolla i përdor të dhënat e gjurmimit për përmirësimin e aktivitetit vjetor	81.0	76.3	93.3

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e raportit për shkollën "Hamdi Bushati". Krahasimet duhen interpretuar me kujdes: në 2026 morën pjesë 15 mësues dhe 12 biznese, ndërsa 88.7% e nxënësve me përgjigje të vlefshme për klasën ishin në klasën e trembëdhjetë. Për prindërit, pjesëmarrja e vetëm 2 personave nuk lejon përgjithësime ose krahasime të besueshme.

1. Të kuptohet përvoja e nxënësve gjatë praktikës

Pas çdo periudhe praktike të zhvillohet një bisedë vlerësuese me nxënësit për të identifikuar vështirësitë. Planet e praktikës të rishikohen me bizneset pritëse dhe të ndiqet realizimi i detyrave të parashikuara.

Gjetja: Praktika në biznes raportohet nga 95.8% e nxënësve, por kënaqësia me mundësitë e praktikës ra nga 80.4% në 63.3% dhe me realizimin sipas planit nga 77.8% në 66.9%. Në 2026, vetëm 66.7% e bizneseve të anketuara i vlerësojnë planet e praktikës si të përshtatura me nevojat e tyre.

2. Materiale informuese dhe aktivitete marketingu më të dobishme

Materialet informuese të rishikohen me nxënësit dhe mësuesit, që informacioni për shkollën dhe profilet të jetë i qartë, i përditësuar dhe i kuptueshëm. Përpara planifikimit të aktiviteteve të ardhshme, të mblidhen sugjerimet e nxënësve për përmbajtjen dhe format e komunikimit.

Gjetja: Kënaqësia e nxënësve me aktivitetet e marketingut ra nga 65.8% në 34.7%. Vlerësimi i cilësisë së informacionit ra nga 79.0% në 56.0% te nxënësit dhe nga 91.7% në 71.4% te mësuesit.

3. Të sqarohet nevoja për mbështetje në mësimdhënie

Njësia e Zhvillimit të organizojë një takim reflektimi me mësuesit për mbështetjen gjatë zbatimit të planit të ZHVP-së dhe të kurrikulës. Diskutimi të plotësohet me mendimet e nxënësve për metodat e mësimdhënies, për të përcaktuar përmirësimet konkrete.

Gjetja: Kënaqësia e mësuesve me mbështetjen për ZHVP-në ra nga 89.2% në 80.0% dhe me mbështetjen e koordinatorit të kurrikulës nga 92.1% në 73.3%. Kënaqësia e nxënësve me metodat e mësimdhënies, si puna në grup, projektet dhe përdorimi i teknologjisë, ra nga 72.5% në 63.2%. Rezultatet e mësuesve mbështeten në 15 përgjigje, nga 38 në 2025.

4. Më shumë pjesëmarrje dhe rezultate të dukshme nga projektet

Të krijohen mundësi të qarta për përfshirjen e mësuesve dhe nxënësve në hartimin dhe zbatimin e projekteve. Pas përfundimit të aktiviteteve, të diskutohen rezultatet dhe dobia e tyre për nxënësit. Baza e treguesve të përfshirjes së mësuesve të sqarohet para interpretimit të ndryshimeve.

Gjetja: Përfshirja e nxënësve në projekte ra nga 66.1% në 56.3%, ndërsa kënaqësia me rezultatet e tyre nga 72.3% në 63.6%. Raporti paraqet 26.7% për përfshirjen e mësuesve në hartim dhe zbatim, por shënimi për bazën e llogaritjes kërkon sqarim.

5. Të dhënat e gjurmimit të përdoren më shumë në mësimdhënie

Gjetjet e gjurmimit të diskutohen në ekipet lëndore, duke përcaktuar si mund të përdoren për përshtatjen e përmbajtjes mësimore, detyrave praktike dhe orientimit të nxënësve.

Gjetja: Përdorimi i të dhënave të gjurmimit për përmirësimin e procesit mësimor ra nga 57.9% në 26.7%, ndërsa vlerësimi se shkolla i përdor ato për përmirësimin e aktivitetit vjetor u rrit nga 76.3% në 93.3%. Ky dallim kërkon diskutim me stafin për të kuptuar si kalojnë gjetjet nga planifikimi në praktikën mësimore.

6. Pjesëmarrje më e gjerë në vlerësimin e ardhshëm

Shkolla të rishikojë mënyrën e shpërndarjes dhe ndjekjes së pyetësorëve, duke synuar përfshirjen e nxënësve nga të gjitha klasat dhe pjesëmarrje më të gjerë të prindërve, mësuesve dhe bizneseve.

Gjetja: Pjesëmarrja e prindërve ra nga 98 në 2, e mësuesve nga 38 në 15 dhe e bizneseve nga 56 në 12. Nga 124 nxënës me përgjigje të vlefshme për klasën, 110 ishin në klasën e trembëdhjetë. Kjo përbërje kufizon pasqyrimin e përvojave të të gjitha grupeve.

Shtojca 1 – Tabela exel me të dhënat nga sondazhi

Shkolla Hamdi Bushati_Indeksi.xlsx